



Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore, vendosjen e menaxhimit me analizë të kapaciteteve dhe mangësive në territorin e Komunës së Ulqinit

Podgoricë, gusht 2023.



Doracak: Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore, vendosjen e menaxhimit me analiza të kapaciteteve dhe mangësive në territorin e Komunës së Ulqinit

IMPRESUM

Kontribuesit / Autorët:

M.Sc., Milena Bataković
Dipl. Biolog, Jelena Marojević Galić
Dr. Petra Zdravković

D.i.A., Zenepa Lika
M.Sc., Elodi Jakupi
Arsllan Hajdinaga

Kontaktet:

Dr. Martin Schneider-Jacoby Assoc. - MSJA,
Rr.. Pavle Knezheviq No. 7/ Pinjesh 3,
85360 Ulqin,
e-mail: info@msja.me
Homepage: www.msja.me

Kryeredaktori:

Zenepa Lika

Përkthimi shqip:

Sabra Deçevisq

Fotoja e kopertinës:

MSJA-Dr Dr Martin Schneider-Jacoby Assoc.

Dizajn:

Zenepa Lika

Printimi:

Golbi doo, Podgoricë

Tirazhi:

100 kopje në gjuhë shqipe

Ky publikim është krijuar përmes projektit Identifikimi dhe analiza: "Ullishta e Ulqinit dhe Gjiri i Valdanos - Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore - peizazhit" realizuar nga Shoqata Dr. Martin Schneider-Jacoby Assoc.- MSJA. Projekti është mbështetur nga Qendra për Edukimin Qytetar (QEQ) në kuadër të programit "OSHC-të në Mal të Zi - nga shërbimet bazë deri te formulimi i politikave - M'BASE" financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Administratës Publike.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Dr. Martin Schneider-Jacoby Assoc.- MSJA dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e QEQ, Bashkimit Evropian ose Ministrisë së Administratës Publike.



Përmbajtjas

◆ Hyrje.....	3
◆ Trashëgimia natyrore dhe kulturore në territorin e Ulqinit	4
◆ Kuadri strategjik dhe legjislacioni shtetëror relevant në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe trashëgimisë kulturore	5
Kuadri strategjik dhe legjislacioni shtetëror relevant në fushën e mbrojtjes së natyrës	5
Kuadri strategjik dhe legjislacioni shtetëror relevant në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore	7
◆ Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore	9
Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura.....	9
Procedura për shpalljen e zonave të mbrojtura - renditja e hapave.....	10
Kompetencat në kontekstin e shpalljes së zonave të mbrojtura	12
Konsultimi publik.....	13
Regjistrimi në regjistrin e zonave të mbrojtura.....	14
◆ Vendosja e mbrojtjes së pasurive kulturore.....	14
Kriteret për përcaktimin e vlerës kulturore.....	15
Statusi i pasurisë kulturore	15
Mbrojtja paraprake	16
Vendosja e menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe kapaciteteve të nevojshme.....	16
Vendosja e menaxhimit të zonave të mbrojtura në Mal të Zi	18
◆ Menaxhimi i pasurive kulturore	22
Përdorimi (shfrytëzimi) i zonave të mbrojtura.....	23
◆ Përdorimi i pasurive kulturore	23
◆ Të drejtat dhe detyrimet e personave fizikë dhe juridikë në zonat e mbrojtura.....	24
◆ Të drejtat dhe detyrimet e pronarëve dhe mbajtësve të pasurisë kulturore.....	25
◆ Analiza e kapaciteteve dhe mangësive në Komunën e Ulqinit për vendosjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore	28
◆ Rekomandime	29
◆ Literatura:.....	30
◆ Shtojca I - Rezultatet e Pyetësorit	31



◆ Hyrje

Mbrojtja e natyrës paraqet një sërë masash dhe aktiviteteve që synojnë parandalimin e dëmtimit të natyrës, vlerave natyrore dhe ekuilibrit natyror. Një nga këto masa është vendosja dhe përcaktimi i pasurive natyrore të mbrojtura dhe sistemi i monitorimit për mbrojtjen e tyre.

Zonë e mbrojtur është zonë e përcaktuar qartë që njihet për nga qëllim dhe që menaxhohet me synimin për të ruajtur në mënyrë të përhershme të gjithë natyrën, shërbimet e ekosistemit që ajo ofron dhe vlerat kulturore që lidhen me të, në mënyrë ligjore ose në një mënyrë tjetër efikase. Ky definicion i zonave të mbrojtura, pas shumë rishikimeve dhe ndryshimeve nga ekspertë të shumtë brenda Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) dhe Komisionit Botëror për Zonat e Mbrojtura (WCPA), u pranua në versionin e tij përfundimtar në Kongresin Botëror për Ruajtjen e Natyrës në Barcelonë në vitin 2008.

Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Mal të Zi ka një traditë të gjatë, duke filluar nga viti 1878, kur knjazi i atëhershëm Nikolla shpalli ndalimin e parë të gjuetisë në Mal të Zi, në zonën e Parkut Kombëtar të sotëm të Biogradit. Mali i Zi fitoi zonat e para të mbrojtura në vitin 1952, kur u shpallën këto parqe nacionale: Lovçeni, Durmitori dhe Biogradit. Pas kësaj u shpallën dhe PN Liqeni i Shkodrës (1983) dhe PN Bjeshkët e Nemuna (2009).

Deri më sot, në shtetin tonë janë shpallur gjithsej 80 zona të mbrojtura, me një sipërfaqe prej 190138.41 ha, pra 182572.35 ha në tokë (13.22%) dhe 4567.26 ha (1.87%) të territorit ujor të Malit të Zi. Nga kjo, pjesa më e madhe (7.271%) përbëhet nga pesë parqe nacionale.

Lloji i zonës së mbrojtur (ZB)	Numri i ZB	Sipërfaqja totale tokësore (ha)	Sipërfaqja totale ujore (ha)
Park nacional	5	100427	
Park i natyrës	9	84344.32	4563,76
Rezervat i veçantë natyror	2	153.474989	3,47
Rajon me cilësi të jashtëzakonshme	2	196.05	
Monument i natyrës	59	4597.5665	
Rezervat i rreptë i natyrës	3	420	
	80.00	190138.41	4567,26

Tabela 1. Pasqyrë e zonave të mbrojtura në Mal të Zi, sipas kategorisë dhe sipërfaqes

Trashëgimia kulturore, e cila ndahet në materiale dhe jomateriale, është shprehje e besimeve, aspiratave, vlerave, arritjeve dhe përvojave të njerëzve në një territor të caktuar dhe për rrjedhojë paraqet burim njohurish për një bashkësi të caktuar njerëzore dhe më gjerë. Për të ruajtur dëshmitë e së kaluarës dhe për brezat e ardhshëm, shteti vendos **sistem të mbrojtjes** së trashëgimisë kulturore dhe themelon **institucione** që i përkushtohen ekskluzivisht kësaj detyre.

Fillimet e mbrojtjes institucionale dhe legjislativë të trashëgimisë kulturore në Mal të Zi datojnë në mesin e shekullit të 20-të, kur në vitin 1948 u themelua Instituti për Mbrojtjen dhe Hulimtimin Shkencor të Monumenteve të Kulturës dhe Rrallësive Natyrore, dhe në vitin 1949 Ligji për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Rrallësive Natyrore ka hyrë në fuqi në Republikën e Malit të Zi.



Ligji për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore i vitit 2010, i cili në vend të termit të mëparshëm "monument kulture" shënon termin pasuri të paluajtshme kulturore, rregullon llojet dhe kategoritë e pasurisë kulturore, mënyrën e vendosjes së mbrojtjes, regjimin dhe masat e mbrojtjes, të drejtat dhe detyrimet e pronarëve dhe mbajtësve të pasurive kulturore dhe çështje të tjera me rëndësi për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive kulturore.

◆ **Trashëgimia natyrore dhe kulturore në territorin e Ulqinit**

Në territorin e Komunës së Ulqinit janë 10 zona të mbrojtura. Prej tyre, dy janë në kategorinë e parkut të natyrorës: Parku i Natyrës Kriporja e Ulqinit, i cili u shpall zonë e mbrojtur në vitin 2019 dhe që menaxhohet përkohësisht nga Ndërmarrja Publike për Parqet Nacionale të Malit të Zi, si dhe Parku i Natyrës Ulqini i Vjetër i shpallur në vitin 2022, i cili menaxhohet nga Ndërmarrja Publike për të Mirat Detare e Malit të Zi. Përveç kësaj, në territorin e kësaj komune ekzistojnë dy zona: Ulqini i Vjetër (ishulli dhe plazhi) dhe Plazhi i Madh afër Ulqinit, të mbrojtura në kategorinë e monumenteve të natyrës, të cilat gjithashtu menaxhohen nga NP për të Mirat Detare. Përveç kësaj Lisi Holm (*Quercus ilex*) - Ulqin, poshtë fshatit Kominë, Lisi Holm (*Quercus ilex*) - Ulqin, në Liman, Lisi Bungëbutë (*Quercus pubescens*) - Ulqin, në Krythë, Lisi Bungëbutë (*Quercus pubescens*) - Ulqin, në Zogaj, Lisi i Përnarit (*Quercus coccifera*) - Ulqin, poshtë Hotelit Jadran, dhe Lisi i Përnarit (*Quercus coccifera*), grup pemësh - Ulqin, në Meteriz, të gjitha në kategorinë e monumentit të natyrës dhe pa menaxhues të caktuar. Për këto zona është duke u zhvilluar procedura e auditimit.

Komuna e Ulqinit është e pasur me trashëgimi kulturore, kështu që përveç objekteve dhe tërësive që mbrohen me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore, këtu hasim në një pjesë të vogël të lokaliteteve arkeologjike, objekteve ambientale dhe strukturave individuale që dëshmojnë për jetën në këtë zonë. Përveç bukurive të jashtëzakonshme natyrore, qyteti më jugor i bregdetit malazez, me Qytetin e Vjetër që magjeps me pamjen, bukurinë dhe shtresat e akumuluar kulturore, me strukturë demografike që është një shembull i jashtëzakonshëm i një mjedisi multikulturor dhe bashkëjetesës së mirë të banorëve të tij, ka një trashëgimi të jashtëzakonshme kulturore-historike, shembuj të bukur ndërtesash të shenjta dhe profane, objekte arkeologjike në tokë dhe nën det, si dhe tërësi pak a shumë të ruajtura të arkitekturës tradicionale.

Tërësia kulturo-historik e Qytetit të Vjetër, që është trashëgimi kulturore jashtëzakonisht e rëndësishme nga periudha të ndryshme të së kaluarës sonë, vazhdimësia e së cilës mund të gjurmohet që nga periudha iliro-greke, nëpër periudha romake, mesjetare, veneciane dhe osmane e deri në ditët tona, karakterizohet nga vlerat kulturore me rëndësi të jashtëzakonshme.

Në territorin e komunës së Ulqinit ekzistojnë 13 pasuri të paluajtshme kulturore të mbrojtura me Ligj, përkatësisht:

- Qyteti i Vjetër i Ulqinit
- Qytetit i fortifikuar i Svaçit (Shasit)
- Kisha-Xhami
- Kisha Katedrale e Shën Nikollës
- Shtëpia e Beqir begut
- Xhamia e Pashës me hamam, nënqytet
- Kisha e Shën Nikollës nën Malin e Bardhë
- Kulla e Sahatit, nënqytet



Doracak: Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore, vendosjen e menaxhimit me analiza të kapaciteteve dhe mangësive në territorin e Komunës së Ulqinit

- Shtëpia e Pashës, nënqytet
- Xhamia Namazgjah
- Lokaliteti i Kruçit

Pasuritë e paluajtshme kulturore përfshijnë edhe dy pllaka përkujtimore dhe një objekt përkujtimor:

- Pllakë përkujtimore për shtatë luftëtarët e rënë në LNÇ
- Pllakë përkujtimore për luftëtarët e rënë për çlirimin e Ulqinit
- Shtëpia e revolucionarit Nikolla Gj. Gjakonoviq

◆ **Kuadri strategjik dhe legjislativi shtetëror relevant në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe trashëgimisë kulturore**

Kuadri strategjik dhe legjislativi shtetëror relevant në fushën e mbrojtjes së natyrës

Disa dokumente strategjike formojnë kornizën për mbrojtjen e natyrës në Mal të Zi. Ato janë:

Strategjia Shtetërore për Zhvillimin e Qëndrueshëm deri në vitin 2030 (SSHZHQ 2030), e cila u miratua në vitin 2016, paraqet agjendën e mbartur së OKB-së për zhvillimin e qëndrueshëm deri në vitin 2030 (të gjithë 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe 167 nga 169 detyrat) në nivel shtetëror. Ky dokument ofron pasqyrë të vlerësimit të gjendjes së të gjitha resurseve, përfshirë ato natyrore, dhe identifikon tendencat kryesore të paqëndrueshme, si dhe nevojat për zhvillim të qëndrueshëm deri në vitin 2030. Gjithashtu, ky dokument përcakton qëllimet strategjike dhe masat si dhe planin e veprimit për menaxhimin e resurseve.

Strategjia Shtetërore për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare (SSHMIZB) e miratuar në vitin 2015 paraqet një kuadër strategjik shtetëror që kontribuon në zbatimin e Strategjisë së BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit dhe përfshin një numër të konsiderueshëm masash për mbrojtjen e natyrës në rajonin bregdetar. **SSHMIZB** përfshinte mbrojtjen e natyrës nëpërmjet aplikimit të instrumenteve për mbrojtjen e pasurive natyrore, habitateve dhe ekosistemeve me vlerë ekologjike.

Strategjia shtetërore për mbrojtjen e diversitetit biologjik me Planin e Veprimit 2016-2020 - është dokumenti kyç për mbrojtjen e natyrës sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, i cili përcakton objektivat dhe udhëzimet afatgjata për ruajtjen e diversitetit biologjik dhe mjedisor. Strategjia gjithashtu mbështet dhe integron objektivat globale të mbrojtjes së biodiversitetit të miratuara sipas Konventës së OKB-së për Mbrojtjen e Biodiversitetit me objektivat Aichi. Periudha e vlefshmërisë së Strategjisë ka skaduar dhe ajo do të rishikohet në periudhën vijuese në përputhje me qëllimet e reja të mbrojtjes së biodiversitetit të arritur në Konferencën e palëve nënshkruese të Konventës së OKB-së për Biodiversitetin (CBD COP 15).

Plani Hapësinor i Malit të Zi deri në vitin 2020, si dhe **Plani Hapësinor me Dedikim të Veçantë për Zonën Bregdetare** i miratuar në vitin 2018 - është në proces përgatitja e Planit të ri Hapësinor të Malit të Zi. Kur bëhet fjalë për organizimin institucional të sektorit të mbrojtjes së natyrës, përgjegjësitë ndahen ndërmjet një numri të madh departamentesh, organesh të administratës shtetërore, institucioneve dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore. Këtu do të listojmë vetëm disa prej tyre.



Ministria e Ekologjisë, Planifikimit Hapësinor dhe Urbanizmit (MEPPU) është organi ombrellë përgjegjës për: miratimin e politikave në lidhje me mbrojtjen e natyrës, miratimin e legjislacionit, harmonizimin e legjislacionit me politikën e BE-së dhe acquis ligjorë lidhur me mbrojtjen e natyrës. Ministria gjithashtu ka një rol qendror në mbikëqyrjen e planifikimit hapësinor në Mal të Zi. MEPHU kryen mbikëqyrje administrative mbi punën e disa institucioneve publike, duke përfshirë:

- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA)
- NP për të Mirat Detare (NPMĐ)
- NP Parqet Nacional të Malit të Zi (NPPN)

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Malit të Zi (EPA) ka një sërë përgjegjësish në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe zonave të mbrojtura, si: monitorimi i gjendjes së biodiversitetit (habitateve dhe specieve), punimi i studimeve për mbrojtjen në procesin e vendosjes të zonave të mbrojtura, lejet për punët dhe aktivitete në zonat e mbrojtura, hulumtimet shkencore që synojnë mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, përgatitjen dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave në lidhje me mjedisin (përfshirë biodiversitetin), zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimet strategjike të ndikimit, lejet për grumbullim, mbarështim, mbajtje dhe tregtim të llojeve të kafshëve dhe bimëve të egra dhe kërpudhave, mbrojtjen dhe lejet për veprimtari hulumtuese-shkencore dhe edukative në zonat natyrore të mbrojtura, si dhe për veprimtari speleologjike, përcaktimin e masave për mbrojtjen e habitateve dhe specieve, zbatimin e procedurave të vlerësimit të pranueshmërisë, përcaktimin e interesit publik mbizotërues dhe masat kompensuese, aktivitetet edukative dhe sigurimin e qasjes së lirë për informacion nga fusha e mbrojtjes së natyrës. Agjencia, poashtu, jep mendim në procesin e miratimit të Planit për Menaxhimin e Zonave të Mbrojtura.

Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e të Mirave Detare (NPMĐ) ka rolin e menaxhuesit të të mirave detare për nevoja të përgjithshme dhe të veçanta publike në përputhje me dispozitat e Ligjit shtetëror për të Mirat Detare, si dhe dhënien në përdorim të plazheve dhe lokacioneve për vendosjen e objekteve të përkohshme turistike dhe shërbyese gjatë sezonit veror. Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, kjo kompani publike është përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura në zonën e të mirave detare dhe për këtë arsye menaxhon me Parkun e Natyrës Ulqini i Vjetër, si dhe monumentet natyrore të Ulqinit të Vjetër (ishulli dhe plazhi) dhe Plazhin e Madh.

Ndërmarrja Publike Parqet Nationale të Malit të Zi (NPPN) është përgjegjëse për menaxhimin e parqeve nacionale në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligjin për Parqet Nationale, dhe ata janë drejtuesit me përvojën më të gjatë në menaxhimin e zonave të mbrojtura në Mal të Zi. Që nga themelimi i Parkut të Natyrës Kriporja e Ulqinit, ata janë emëruar drejtues i përkohshëm derisa Komuna e Ulqinit të formojë ndërmarrjen përgjegjëse për menaxhimin e kësaj zone.

Vetëqeverisjet lokale janë përgjegjëse për çështjet: (i) planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik, (ii) përgatitjen e studimeve të lokacionit, (iii) sigurimin financiar dhe buxhetor, (iv) shpalljen e zonave të mbrojtura të kategorisë III me përjashtim të zonave të mbrojtura detare, (v) emërimi i drejtuesve për zonat e mbrojtura ose administrimi i zonave të mbrojtura që ata shpallin.

Organizatet turistike lokale luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e vendeve tërheqëse turistike, disa prej të cilave mbrohen me ligj ose janë planifikuar për mbrojtje, **inspektionet komunale dhe policia** poashtu luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm.


Një numër i madh ligjesh dhe dispozitash rregullojnë mbrojtjen e natyrës dhe zonat e mbrojtura në Mal të Zi, gjë që tregon ndërvarësinë e një numri të madh të fushave.

Ligjet ombrellë që lidhen me zonat e mbrojtura janë **Ligji për Mbrojtjen e Natyrës** dhe **Ligji për Parqet Nationale**, me një numër aktesh nënligjore. Përveç kësaj, ekzistojnë ligje që rregullojnë forma të ndryshme të përdorimit të resurseve natyrore dhe aktiviteteve (gjuetia, peshkimi, bujqësia, ndërtimi, etj.)



Ligji për Mbrojtjen e Natyrës rregullon kushtet dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, objektivat e mbrojtjes së natyrës, përcakton subjektet e mbrojtjes së natyrës dhe detyrimet e tyre. Ky ligj përcakton që pasuritë natyrore të mbrojtura mund të shpallen pjesë të zgjedhura të natyrës që kanë diversitet të theksuar biologjik, gjeologjik, ekosistemik ose rajonal, si dhe që pasuritë natyrore të mbrojtura përfshijnë:

- Zonat e mbrojtura - rezervat i rreptë dhe i veçantë i natyrës, park nacional, park i natyrës, monument i natyrës dhe zona me karakteristika të jashtëzakonshme dhe
- Zonat e rrjetit ekologjik
- Gjithashtu, Ligji përcakton dokumentet për mbrojtjen e natyrës, përmbajtjen e tyre, procedurën e miratimit dhe raportimit, të cilat do të diskutohen më në detaje në kapitullin vijues.



Skema 1. Ligjet kryesore në fushën e mbrojtjes së natyrës

Kuadri strategjik dhe legjislativi shtetëror relevant në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore

Formimi i Administratës për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore është rezultat i transformimit të institucioneve të mëparshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (Institutit Republikan për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, Institutit Rajonal për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Qendrës për Hulumtime Arkeologjike të Malit të Zi) në një kornizë të re institucionale të përbërë nga Drejtoria për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore dhe Qendra për Konservim dhe Arkeologji të Malit të Zi. Qëllimi i transformimit të institucioneve të mëparshme për mbrojtjen e pasurisë kulturore është krijimi i sistemit funksional, efikas dhe efektiv të mbrojtjes, ruajtjes dhe avancimit afatgjatë të pasurisë kulturore, duke siguruar përdorim të qëndrueshëm. Gjithashtu, Drejtoria për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore kryen punë




administrative dhe profesionale përkatëse, dhe përveç detyrave që kanë të bëjnë me zbatimin e masave për mbrojtjen e pasurive kulturore, Drejtoria kryen edhe detyra për vendosjen e mbrojtjes së pasurive kulturore. Nga ana tjetër, Qendra kryen detyra nga fusha praktike, të cilat përfshijnë përgatitjen e projektit dhe dokumentacionit tjetër dhe zbatimin e masave hulumtuese dhe konservuese të pasurive kulturore.


Mbikëqytja e punës së këtyre institucioneve dhe organeve shtetërore bëhet nga ana e Ministrisë e Kulturës dhe Medieeve. Përveç institucioneve shtetërore, si aktorë të rëndësishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore njihen edhe institucionet lokale të kulturës, si sekretariatet lokale përgjegjëse për aktivitetet kulturore dhe planifikimin hapësinor.

Kështu, për të gjitha ndërhyrjet në pasuritë kulturore, apo për pjesë të tjera të trashëgimisë kulturore, qytetarët mund t'i drejtohen njërit prej institucioneve të lartpërmendura.

Ligji kyç në kontekstin e mbrojtjes fizike të trashëgimisë kulturore është **Ligji për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore**. Ai rregullon llojet dhe kategoritë e pasurisë kulturore, mënyrat e vendosjes së mbrojtjes, regjimin dhe masat e mbrojtjes, të drejtat dhe detyrimet e pronarëve dhe mbajtësve të pasurive kulturore, si dhe çështje të tjera me rëndësi për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë kulturore. Ky akt përmban të gjithë mekanizmat dhe parashikon procedurat për mbrojtjen e pasurive kulturore, si dhe mbrojtjen integrale të trashëgimisë së përgjithshme kulturore. Shtjellimi shtesë i këtyre çështjeve përcaktohet me akte nënligjore.



Skema 2. Institucionet kompetente



Skema 3. Ligjet dhe aktet nënligjore kryesore në fushën e trashëgimisë kulturore

◆ **Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore**

Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Fletorja Zyrtare e Malit të Zi nr. 54/16) përcakton procedurat për vendosjen e zonave të mbrojtura. Sipas ligjit, pjesët e natyrës me vlerë të jashtëzakonshme, të cilat karakterizohen nga diversiteti biologjik, gjeologjik, ekosistem dhe rajonal, mund të shpallen pasuri natyrore të mbrojtura dhe vetë procedura e mbrojtjes varet nga kategoria e pasurisë natyrore të mbrojtur.

Pasuritë natyrore të mbrojtura janë:

1) zonat e mbrojtura:

- rezervat i rreptë i natyrës,
 - park nacional,
 - rezervat i veçantë natyror,
 - park i natyrës,
 - monument i natyrës dhe
 - rajon me cilësi të jashtëzakonshme.

2) zonat e rjetit ekologjik.



Emri i kategorisë	Përkufizimi
Rezervat i rreptë i natyrës	Rezervat i rreptë i natyrës është një zonë tokësore ose detare, respektivisht tokësore dhe detare me ekosisteme të jashtëzakonshme ose reprezentative, me natyrë të përgjithshme të pandryshuar ose pak të ndryshuar, dhe shërben ekskluzivisht për monitorimin e gjendjes dhe ruajtjen e natyrës origjinale dhe për hulumtime shkencore që nuk ndryshon karakteristikat themelore dhe nuk rrezikon zhvillimin e lirë të dukurive dhe proceseve natyrore.
Park nacional	Parku nacional është një zonë natyrore tokësore ose detare, respektivisht tokësore dhe detare, e cila është caktuar për të mbrojtur integritetin ekologjik të një ose më shumë ekosistemeve për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, në mënyrë që të parandalohet përdorimi joadekuat i resurseve të natyrës ose veprime dhe aktivitete të tjera të dëmshme dhe për të siguruar nevojat shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative dhe nevojat e vizitorëve që janë në përputhje me ruajtjen e mjedisit dhe kulturës.
Rezervat i veçantë natyror	Rezervat i veçantë natyror është një zonë tokësore ose detare, respektivisht tokësore dhe detare me rëndësi të veçantë për shkak të veçantisë, rrallësisë ose përfaqësimit të vlerave natyrore, e cila përfshin habitatin e specieve të egra të rrezikuara të bimëve, kafshëve dhe kërpudhave. në të cilën njeriu jeton në harmoni me natyrën dhe që mbrohet për ruajtjen e kushteve dhe vlerave natyrore.
Parku i natyrës	Park i natyrës është një zonë e madhe natyrore ose pjesërisht e kultivuar e tokës dhe/ose detit, e cila karakterizohet nga një nivel i lartë diversiteti biologjik dhe/ose vlera gjeologjike të rëndësishme rajonale, kulturore dhe historike dhe veçori ekologjike me rëndësi shtetërore dhe ndërkombëtare.
Monument i natyrës	Monument i natyrës është një zonë tokësore ose detare, respektivisht tokësore dhe detare, në të cilën ka një ose më shumë forma natyrore ose natyrore-kulturore, që kanë vlerë ekologjike, shkencore, estetike, kulturore ose arsimore.
Rajon me karakteristika jashtëzakonshme	Rajon me karakteristika të jashtëzakonshme është një lokalitet tokësor ose detar, respektivisht tokësor dhe detar, ku ndërveprimi i njerëzve dhe natyrës me kalimin e kohës ka formuar tipare të dallueshme të lokalitetit me vlera të rëndësishme estetike, ekologjike dhe kulturore, të shoqëruara me diversitet të lartë biologjik.

Tabela 2. Llojet dhe përkufizimet e zonave të mbrojtura

Procedura për shpalljen e zonave të mbrojtura - renditja e hapave

Renditja e hapave në procedurën e shpalljes për të gjitha zonat e mbrojtura në Mal të Zi është e njëjtë dhe tregohet në skemën 4.



Skema 4. Renditja e hapave në procedurën e shpalljes së zonave të mbrojtura

Studimi i mbrojtjes është dokumenti profesional më i rëndësishëm në procesin e shpalljes së zonave të mbrojtura dhe jep informacion të saktë për vlerën e zonës nga aspekti i mbrojtjes, si dhe për propozimin e konceptit të ardhshëm të mbrojtjes.

Prandaj, studimi duhet të përmbajë: përshkrimin e veçorive natyrore, të krijuara dhe rajonale të pasurisë natyrore, karakteristikat respektivisht vlerën e lokalitetit, gjendjen ekzistuese të resurseve me vlerësimin e valorizimit të tyre, renditjen hapësinore me pasqyrë hartografike të shpërndarjes së habitateve dhe specieve më të rëndësishme (qëllimet e mbrojtjes), vlerësimin e gjendjes së zonës, koordinatën qendrore e zonës së mbrojtur, mendimin në lidhje me vendosjen e pasurisë natyrore në mbrojtje, propozimin për klasifikimin e pasurisë natyrore sipas rëndësisë, propozimin për kategoritë dhe zonat e mbrojtjes (regjimi i mbrojtjes), propozimin për kufijtë hapësinorë të zonës së mbrojtur me kufijtë e zonave dhe regjimet e mbrojtjes, hartën që tregon kufijtë e zonës së mbrojtur, pra me përcaktimin e lokacionit bazuar në të dhënat nga kadastra e patundshmërive, konceptin e mbrojtjes, avancimit, zhvillimit të qëndrueshëm, mënyrën e menaxhimit të zonës, propozimin e masave dhe kushteve për mbrojtje, propozimin e veprimeve, aktiviteteve dhe veprimeve që mund të kryhen në zonat dhe regjimet e mbrojtjes, aktivitetet, veprimet dhe veprimtaritë që nuk mund të kryhen në zona dhe regjime të caktuara të mbrojtjes, pasojat që do të rezultojnë nga miratimi i aktit të shpalljes, veçanërisht në lidhje me të drejtat e pronësisë dhe veprimtaritë ekonomike ekzistuese, si dhe burimet orientuese financiare për zbatimin e aktit për shpalljen e pasurisë natyrore të mbrojtur dhe elementë të tjerë me rëndësi për vendosjen në mbrojtje të pasurive natyrore.

Zonat dhe regjimet e mbrojtjes

Për përcaktimin e regjimit të mbrojtjes brenda zonës së mbrojtur, në Studimin e Mbrojtjes, bazuar në analizën e vlerave natyrore dhe masat e nevojshme për mbrojtje, përcaktohen zonat e mbrojtjes të cilat mund të jenë:

- Zona e mbrojtjes I - regjim i rreptë i mbrojtjes, realizohet në një zonë të mbrojtur ose pjesë të saj me karakteristika pak të ndryshuara të habitateve me rëndësi të jashtëzakonshme ekologjike, të cilat mundësojnë procese biologjike natyrore, ruajtjen e integritetit të habitateve dhe bashësive të gjalla, përfshirë dhe pasuritë kulturore jashtëzakonisht të vlefshme.
- Zona e mbrojtjes II - regjimi aktiv i mbrojtjes, kryhet në një zonë të mbrojtur në të cilën karakteristikat e habitateve natyrore janë ndryshuar pjesërisht, por jo në atë shkallë sa të rrezikohet rëndësia e tyre ekologjike, përfshirë dhe zonat me vlerë dhe objektet e gjeotrahëgimisë.
- Zona III e mbrojtjes me regjim përdorimi të qëndrueshëm dhe jashtë kufijve të zonës së mbrojtur, sipas nevojës mund të përcaktohet një brez mbrojtës për të parandaluar ose zbutur faktorët e jashtëm që mund të kenë ndikim negativ në zonën e mbrojtur, si p.sh. : ujërat e zeza, mbetjet e ngurta, speciet invazive, ndërtimet ilegale, turizmi, shpëlarja e pesticideve, herbicideve dhe kimikateve të tjera, zjarret, pyllëzimi me specie bimore jovendase dhe faktorë të tjerë të mundshëm.



Emri i zonës	Aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara
Zona e mbrojtjes I - regjim i rreptë i mbrojtjes	<ul style="list-style-type: none"> - ndalohet përdorimi i resurseve natyrore dhe ndërtimi i objekteve; - Hulumtimi shkencor dhe monitorimi i proceseve natyrore kryhen (monitorimi) në një shkallë të kufizuar; - vizitat për qëllime edukative lejohen në një masë të kufizuar; - zbatohen masat e mbrojtjes, sanuese dhe të tjera të nevojshme në rast zjarri, fatkeqësish natyrore dhe aksidentesh, shfaqjes së sëmundjeve të bimëve dhe kafshëve dhe mbipopullimit të dëmtuesve.
Zona e mbrojtjes II – regjim i mbrojtjes aktive	<p>Mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kryehen ndërhyrje që synojnë restaurimin, rivitalizimin dhe përmirësimin e përgjithshëm të zonës së mbrojtur; - përdoren në mënyrë të kontrolluar resurset natyrore, pa pasoja për vlerën parësore të habitateve të tyre natyrore, popullatave, ekosistemeve, veçorive të zonës dhe objekteve të gjeotrashëgimisë.
Zona e mbrojtjes III - regjimi i përdorimit të qëndrueshëm	<p>Mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kryehen ndërhyrje që synojnë restaurimin, rivitalizimin dhe përmirësimin e përgjithshëm të zonës së mbrojtur; - zhvillohen vendbanimet dhe infrastruktura përcjellëse në masën që të mos cenohen vlerat bazë të zonës; - kryehen punime për rregullimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe të ndërtimit tradicional; - bëhet ruajtja e aktiviteteve tradicionale të popullsisë vendase; - përdoren në mënyrë selektive dhe të kufizuar resurset natyrore.

Tabela 3. Zonat dhe regjimet e mbrojtjes me aktivitete të lejuara dhe të ndaluara

Duhet theksuar se lista më e gjerë e aktiviteteve të lejuara dhe të ndaluara brenda zonave të caktuara të mbrojtura përcaktohet nga Studimi i Mbrojtjes dhe Akti i Shpalljes bazuar në specifikën e zonës, pra nevojat specifike për mbrojtjen e vlerave kyçe natyrore që janë arsyeja e mbrojtjes së zonës.

Kompetencat në kontekstin e shpalljes së zonave të mbrojtura

Në lidhje me kategorinë e mbrojtjes dhe nëse zona ndodhet në territorin e një ose më shumë komunave apo është zonë e mbrojtur detare, kategoritë e ndryshme të mbrojtjes janë përcaktuar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe janë dhënë në Tabelën 3.

Emri i kategorisë	Organi që paraqet iniciativën	Organi që miraton Aktin e Shpalljes
Parku nacionalni	Ministria	Kuvendi i Malit të Zi
Rezervat i rreptë i natyrës	Ministria	Qeveria
Rezervat i veçantë i natyrës		



Park i natyrës Monument i natyrës Rajon me karakteristika të jashtëzakonshme	Administrata lokale	Nëse ndodhen në territorin e një njësie të vetëqeverisjes lokale, kjo shpallet nga kuvendi i njësisë së vetëqeverisjes lokale. Nëse ndodhen në territorin e disa njësive të vetëqeverisjes lokale, kjo shpallet nga Qeveria me propozimin e njësive të vetëqeverisjes lokale në territorin e të cilave ndodhen. ¹ Zonat e mbrojtura detare, territori i të cilave pjesërisht ose tërësisht hyn në zonën e të mirave detare, shpallet nga Qeveria, me përjashtim të parkut nacional.
---------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Tabela 4. Kompetencat në kontekst të procedurës së shpalljes

Konsultimi publik

Propozuesi i aktit nga tabela 3 informon publikun për propozimin e aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur dhe i jep publikut qasje në studimin e mbrojtjes dhe propozim aktin për shpalljen e zonës së mbrojtur dhe organizon diskutim publik. Njoftimi publikohet në të paktën një media të shkruar dhe përmban informacion për kohën dhe vendin për qasje dhe diskutimit publik.

Propozuesi i aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur është i detyruar të njoftojë me shkrim pronarët e pronës së paluajtshme për synimin për vendosjen e zonës në mbrojtje dhe të mundësojë qasje në studimin e mbrojtjes.

Qasja publike në studimin e mbrojtjes dhe aktin për shpalljen e zonës së mbrojtur duhet të zgjasë të paktën 20 ditë nga data e publikimit të njoftimit.

Mbrojtja parandaluese (preventive)

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës parashikon gjithashtu mekanizmin e mbrojtjes parandaluese që mund të inicohet për një zonë për të cilën organi administrativ, në bazë të analizave të ekspertëve vlerëson se ka statusin e zonës së mbrojtur ose është nisur procedura për vendosjen e zonës në mbrojtje, miratohet akti për mbrojtjen parandaluese të zonës.

Aktin për mbrojtjen parandaluese e miratojnë organet nga tabela 3, varësisht nga kategoria e vlerësuar, me propozim të organit administrativ.

Akti për mbrojtjen parandaluese të zonës përcakton menaxhuesin e zonës për të cilën është miratuar akti për mbrojtjen parandaluese, masat, kushtet e mbrojtjes dhe afati i mbrojtjes parandaluese.

Afati i vlefshmërisë së aktit për mbrojtjen parandaluese nuk mund të jetë më i gjatë se tre vjet nga data e miratimit të aktit për mbrojtjen parandaluese të zonës. Zona për të cilën është miratuar akti për mbrojtjen parandaluese të zonës ose është nisur procedura për vendosjen e saj në mbrojtje

¹ sipas pëlqimit të marrë më parë nga Ministria dhe mendimit të organeve të administratës shtetërore përgjegjëse për bujqësinë, pylltarinë dhe menaxhimin e ujërave dhe kulturë.



konsiderohet e mbrojtur dhe për të zbatohen të njëjtat rregulla për mbrojtjen si për të gjitha zonat e tjera të mbrojtura.

Regjistrimi në regjistrin e zonave të mbrojtura

Zonat e mbrojtura dhe zonat nën mbrojtje parandaluese regjistrohen në regjistrin e zonave të mbrojtura që mbahet nga organi administrativ. Të dhënat nga regjistri janë publike, me përjashtim të të dhënave për shpërndarjen e specieve të rralla ose të ndjeshme të synuara dhe llojeve të habitateve dhe vlerave të tjera natyrore me rëndësi për mbrojtjen. Në regjistër shënohen këto të dhëna: emri dhe lloji i zonës së mbrojtur, kategoria, sipërfaqja e zonës së mbrojtur dhe parcelat kadastrale. Pjesë e regjistrit janë dhe koleksionet e dokumenteve: studimi i mbrojtjes me paraqitje hartografike dhe akti për shpalljen e zonës së mbrojtur, studimi i auditimit, akti për ndërprerjen e mbrojtjes së zonës dhe akti për mbrojtjen parandaluese të zonës.

Paraqitje hartografike me kufijtë e vizatuar dhe përcaktimin e lokacionit të zonës së mbrojtur, miratuesi i aktit nga tabela 3 është i detyruar që pas shpalljes t'ia paraqesë organit administrativ, me qëllim të regjistrimit, ose fshirjes, në regjistër dhe në zyrën administrative të organit kompetent për punët kadastrale, si dhe njoftimin për publikimin e aktit për shpalljen ose ndërprerjen e mbrojtjes në "Fletoren Zyrtare të Malit të Zi", gjegjësisht "Fletoren Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale" brenda dhjetë ditëve nga data e publikimi të aktit.

◆ ***Vendosja e mbrojtjes së pasurive kulturore***

Procedura për vendosjen e mbrojtjes është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore, si dhe me Rregulloren për kriteret më të përafërta dhe procedurën për përcaktimin e vlerës kulturore të pasurisë.

Kështu, ligji dhe aktet nënligjore parashikojnë hapat e mëposhtëm:

Mënyra e vendosjes së mbrojtjes

Mbrojtja e pasurisë kulturore vendoset me përcaktimin e mbrojtjes së mëparshme dhe përcaktimin e statusit të pasurisë kulturore. Mbrojtja e pasurisë kulturore vendoset nga Drejtoria, sipas detyrës zyrtare.

Iniciativa për vendosjen e mbrojtjes

Çdokush mund të paraqesë iniciativën pranë Drejtorisë për të vendosur mbrojtjen e pasurisë kulturore. Nisma dorëzohet me shkrim dhe preferohet të përmbajë sa më shumë informacion përshkrues dhe teknik për zonën. Drejtoria është e detyruar të shqyrtojë nismën dhe të njoftojë me shkrim aplikantin e saj, brenda 90 ditëve nga data e paraqitjes së nismës.

Përcaktimi i vlerës kulturore

Vlera kulturore e pasurisë së paluajtshme, të luajtshme dhe jomateriale përcaktohet nga organi ekspert, i përbërë nga të paktën tre anëtarë, i formuar nga Drejtoria.

Vlera kulturore e pasurisë së paluajtshme, të luajtshme dhe jomateriale përcaktohet në bazë të rezultateve të hulumtimit dhe dëshmimeve të tjera relevante për vetitë, rëndësinë dhe veçoritë e pasurisë dhe valorizimin e tyre.



Në procesin e përcaktimit të vlerës kulturore të pasurisë, organi ekspert përgatit elaboratin që përmban përshkrimin e detajuar të veprimeve të kryera dhe mendimin e ekspertit për valorizimin e vetive, veçantive, rëndësisë dhe kategorisë së pasurisë, si dhe përshkrimin, shenjat kadastrale dhe paraqitjen grafike të kufijve të pasurisë së paluajtshme dhe kufijve të mjedisit të saj të mbrojtur, regjimit dhe masat e mbrojtës.

Kriteret për përcaktimin e vlerës kulturore

Kriteret për përcaktimin e vlerës kulturore të një pasurie janë:

1. autenticiteti dhe integriteti;
2. shkalla e ruajtjes;
3. unikësinë dhe rrallshmërinë në llojin e vet;
4. rëndësi historike, artistike, shkencore, arkeologjike, arkitekturore, antropologjike, teknike ose të tjera shoqërore.

Statusi i pasurisë kulturore

Statusi i pasurisë kulturore përcaktohet në bazë të elaboratit për përcaktimin e vlerave kulturore. Procedura për përcaktimin e vlerave kulturore dhe përmbajtja e elaboratit përcaktohet me Rregulloren për kriteret e hollësishme dhe procedurën për përcaktimin e vlerës kulturore të një pasurie.

Aktivendimi për përcaktimin e statusit të pasurisë kulturore


Aktivendimi për përcaktimin e statusit të pasurisë kulturore në varësi të llojit të pasurisë kulturore përmban:

- 1) informacion bazë për pasurinë kulturore (emri, lloji, viti i krijimit, vendndodhja dhe shenjat identifikuese);
- 2) përshkrim i shkurtër i pasurisë kulturore;
- 3) përshkrimi i kufirit të pasurisë së paluajtshme kulturore dhe kufirit të mjedisit të saj të mbrojtur;
- 4) të dhëna për pronarin dhe mbajtësin e pasurisë kulturore dhe mjedisin e mbrojtur të pasurisë kulturore të paluajtshme, kurse për pasurinë jomateriale të dhënat themelore për mbajtësin, gjegjësisht ruajtësin e traditës;
- 5) kategorinë e pasurisë kulturore;
- 6) të dhënat për objektin ku ruhen ose ekspozohen në mënyrë afatgjate pasuria e luajtshme kulturore.

Nëse pasuria kulturore përbëhet nga disa pjesë në të cilat të drejtën e pronësisë kanë disa persona, në aktivendimin për përcaktimin e statusit të pasurisë kulturore, në vend të informacionit për pronarin dhe mbajtësin e pronës, përkatësisht për bartësin, ruajtësin e traditës, atëherë konstatohet pronësia e disa personave.



Doracak: Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore, vendosjen e menaxhimit me analiza të kapaciteteve dhe mangësive në territorin e Komunës së Ulqinit



Skema 5. Përcaktimi i statusit të pasurisë kulturore

Mbrojtja paraprake

Si përjashtim nga procedurat e rregullta, nëse një pasuri kërcënohet me dëmtim, shkatërrim ose zhdukje, mund të vendoset **mbrojtje paraprake** mbi të. Mbrojtja paraprake vendoset mbi pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme që besohet se ka vlerë kulturore, për të parandaluar rrezikun e dëmtimit, shkatërrimit ose zhdukjes. Ajo vendoset në bazë të propozimit të ekspertëve, të cilët bazohen në njohjen e drejtpërdrejtë të gjendjes së pasurisë, dokumentacionin në dispozicion apo fakte të tjera relevante.

Vendosja e menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe kapaciteteve të nevojshme

Modelet e menaxhimit

Përvoja në botë ka treguar se vetëm me shpalljen e zonës së mbrojtur nuk mund të arrihet ruajtja e vlerave të saj, por duhet vendosur menaxhim efektiv dhe të vazhdueshëm. Menaxhimi i zonave të mbrojtura sot shtron kërkesa dhe pritshmëri të mëdha ndaj menaxhuesve, gjë që përveç ruajtjes së vlerës dhe funksionit të zonave të mbrojtura, nënkupton edhe një sërë detyrimesh të tjera. Mbrojtja aktive, monitorimi i gjendjes dhe ruajtja e vlerave, menaxhimi dhe edukimi i vizitorëve janë vetëm disa nga detyrat që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Megjithatë, përgjegjësia dhe pritshmëritë e menaxhuesve të zonave të mbrojtura po rriten sot dhe përfshijnë role të reja që, përveç ruajtjes së natyrës, mbulojnë edhe punën dhe bashkëpunimin me përdoruesit e hapësirës dhe komunitetet lokale, d.m.th. palët e interesuara në një zonë të mbrojtur përmes zhvillimit të qëndrueshëm, respektimit për të drejtat e komunitetit etj.

Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) njihet 4 lloje të gjera të menaxhimit të zonave të mbrojtura, të përcaktuara në bazë të asaj se kush ka juridikcion, përgjegjësi dhe mund të mbahet përgjegjës për vendimet kryesore në lidhje me ato zona të mbrojtura:

- A. Menaxhimi nga shteti
- B. Menaxhimi i përbashkët



- C. Menaxhimi nga personi privat
- D. Menaxhimi nga komunitetet lokale ose grupet indigjene

Menaxhimi nga shteti

Kjo pikëpamje e menaxhimit zbatohet më së shpeshti në të gjithë botën. Kuptimi i menaxhimit nga shteti është se organi i administratës shtetërore (p.sh. Ministria ose agjencia e menaxhimit të parqeve që janë përgjegjës drejtpërdrejt Qeverisë) ka kompetencat, detyrën dhe përgjegjësinë për të menaxhuar zonën e mbrojtur, për të përcaktuar qëllimet e ruajtjes dhe për të krijuar dhe zbatuar planin e menaxhimit për atë zonë. Në këtë menaxhim, Qeveria respektivisht shteti është zakonisht pronar i tokës, ujit dhe resurseve të tjera në zonën e mbrojtur. Për më tepër, njihet edhe modeli ku autoritetet rajonale ose komunale mund të kenë gjithashtu kompetenca për të shpallur dhe menaxhuar zonat e mbrojtura, si dhe të jenë pronarë të tokës dhe resurseve në zonën e mbrojtur.

Një lloj i veçantë i menaxhimit shtetëror të zonave të mbrojtura që gjendet shpesh në zonat e mbrojtura në Evropën Lindore është **menaxhimi i deleguar**, kur përgjegjësia e menaxhimit i kalon subjekteve që nuk i përkasin të njëjtit institucion, p.sh. ministrisë tjetër ose organizatës joqeveritare ose kompanisë private. Në raste të tilla, qeveria/shteti ruan funksionin e kontrollit ose mbikëqyrjes mbi zonën e mbrojtur, por ia beson planifikimin dhe/ose menaxhimin personit juridik parashtetëror, privat, OJQ-së ose komuniteti.

Si shembull i menaxhimit të deleguar, mund të përmendim Parkun e Natyrës të Kripores së Seçovjes në Slloveni, ku Qeveria e Sllovenisë ia delegoi menaxhimin e kësaj zone një kompanisë private telekomunikacioni, përmes mekanizmit të "koncesionit të dyfishtë". Koncesioni i parë lidhet me prodhimin tradicional të kripës nga uji i detit dhe i dyti me menaxhimin e zonës së mbrojtur që përfshin zonat për prodhimin e kripës si dhe rrethinat e saj. Peizazhi i biodiversiteti që u krijua në simbiozë me prodhimin e kripës mund të ruhet vetëm për sa kohë që prodhimi i kripës vazhdon. Menaxhimi i kësaj zone kryhet sipas planit të miratuar nga Qeveria dhe që realizohet nga kompania private.

Menaxhimi i përbashkët/ i ndarë (shared governance)

Zonat e mbrojtura nën menaxhim të përbashkët bazohen në mekanizma dhe procese institucionale që - formalisht dhe/ose informalisht ndajnë kompetencat dhe përgjegjësinë midis disa subjekteve.

Kjo nënkupton që aktorë të ndryshëm (organet shtetërore, rajonale dhe lokale, komunitetet lokale, shoqatat e përdoruesve, sipërmarrësit privatë, pronarët e tokave, etj.) ndajnë kompetencat dhe përgjegjësinë e menaxhimit në marrjen dhe zbatimin e vendimeve. Brenda menaxhimit të përbashkët mund të njihen lloje të ndryshme të menaxhimit siç është, më së shpeshti, menaxhimi kolaborativ (menaxhimi përmes bashkëpunimit), menaxhimi pluralist, si dhe menaxhimi ndërkuftar.

Menaxhimi kolaborativ është formë e menaxhimit të përbashkët në të cilën kompetencat dhe përgjegjësia për vendimmarrje i përket një agjencie, ku ajo është e detyruar, me ligj, të informojë ose konsultojë bartësit e të drejtave dhe palët e tjera të interesit, në kohën e planifikimit ose zbatimit të nismave. Për shembull, pjesëmarrja në menaxhim mund të sigurohet duke u caktuar trupave me shumë aktorë përgjegjës për hartimin e propozimeve teknike për dispozitat që lidhen me zonën e mbrojtur, të cilat më pas i dorëzohen për vendim organit për validim dhe miratim. Në situata të tilla, organi këshillimor që përgatit propozimin teknik ka ndikim të rëndësishëm në vendime. Përfaqësuesit e palëve të ndryshme të interesit ose konstituentët ulen në organin menaxhues me autoritet dhe përgjegjësi vendimmarrëse dhe marrin vendime së bashku me konsensus. Ashtu si në rastin e mëparshëm, kur merren disa vendime, zbatimi i tyre duhet t'u besohet trupave të caktuar, organeve ose individëve të përzgjedhur.

Një formë e menaxhimit të përbashkët i referohet zonave të mbrojtura ndërkuftare, ku menaxhimi përfshin përfshirjen e të paktën dy qeverive dhe aktorëve të tjerë lokal.



Menaxhimi privat

Në këtë lloj menaxhimi dallohen disa lloje: zona menaxhohet nga pronari privat; menaxhohet nga organizata jofitimprurëse (OJQ, universitete, kooperativa); menaxhohet nga organizata fitimprurëse (individë ose subjekte biznesi).

Menaxhimi privat ka një histori të gjatë pasi e ka origjinën nga praktika e ish-aristokracisë që shpesh ruante zona të caktuara, kryesisht për gjueti. Meqenëse biodiversiteti i konsiderueshëm gjendet pikërisht në zonat private, pronësia private sot është ende një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e natyrës. Në këtë lloj menaxhimi, toka zotërohet ose kontrollohet nga një individ, OJQ, kompani ose kooperativë dhe menaxhohet për ruajtjen e biodiversitetit, pavarësisht nëse kjo njihet nga shteti. Toka mund të menaxhohet mbi baza fitimprurëse ose jofitimprurëse. Menaxhimi privat në Mal të Zi mund të gjendet në shembullin e Kopshtit Botanik Dulovina, i cili menaxhohej nga familja Vincek, para se të transferohej në menaxhimin e NPPNMZ me vendim të Qeverisë së Malit të Zi.

Qeverisja nga komunitetet lokale ose popujt indigjenë

Ky lloj menaxhimi është ndoshta forma më e vjetër e menaxhimit të zonave të mbrojtura, dhe si e tillë ende ekziston. IUCN e përkufizon këtë lloj menaxhimi si: "zona të mbrojtura ku kompetenca dhe përgjegjësia e menaxhimit i takon popujve indigjenë dhe/ose komuniteteve lokale nëpërmjet formave të ndryshme të institucioneve dhe rregullave zakonore ose ligjore, formale ose joformale"².

Ky lloj menaxhimi është mjaft i pranishëm në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe përfshin dy lloje: a) zona dhe territore të popujve autoktonë që janë formuar dhe menaxhuar nga popujt indigjenë; dhe b) zonat e ruajtjes së komunitetit të krijuara dhe të menaxhuara nga komunitetet lokale. Ky lloj menaxhimi mund të jetë relativisht kompleks dhe kërkon ekzistencën e institucioneve dhe dispozitave të njohura për të mbajtur strukturën përgjegjëse për arritjen e objektivave të zonës së mbrojtur.

Pavarësisht nga të gjitha llojet dhe modelet e ndryshme të menaxhimit që janë identifikuar, ekziston mendimi që nuk ka "model ideal të menaxhimit" për të gjitha zonat e mbrojtura, as për kategori specifike të zonave të mbrojtura. Nuk ka asnjë variant ideal me të cilin mund të krahasohen modelet e menaxhimit. Strukturat dhe proceset e menaxhimit varen nga kontekstet sociale, politike, mjedisore dhe ekonomike, lokale, shtetërore dhe ndërkombëtare dhe si të tilla duhet të krijohen me kujdes duke u kujdesur për t'iu përgjigjur kërkesave dhe objektivave të zonave të mbrojtura.

Mekanizmat që përdoren më shpesh për të avancuar menaxhimin e zonave të mbrojtura në rajonin e Evropës Lindore janë:³

- 1) agjencitë/ndërmarrjet/administratat për zonat e mbrojtura që u formuan për të koordinuar dhe mbështetur menaxhimin e zonave të mbrojtura;
- 2) menaxhimi i besuar/ dhënë aktorëve qeveritarë/joqeveritare që veprojnë në nivel rajonal/lokal;
- 3) Vendosja e platformave me shumë aktorë të interesuar për të mundësuar vendimmarrje të gjerë me pjesëmarrje.

Vendosja e menaxhimit të zonave të mbrojtura në Mal të Zi

² Dudley, 2008 -IUCN

³ Stanciu & Ionita, 2013



Për menaxhimin me sukses të çdo zone të mbrojtur, është e nevojshme vendosja e strukturës të përshtatshme menaxhimi me staf teknikisht të pajisur dhe të arsimuar për detyrat e mbrojtjes së natyrës, por edhe praktika të qëndrueshme të përdorimit të resurseve natyrore, të cilat, në bashkëpunim dhe ndërveprim të mirë me komunitetin lokal, do të sjellin benefite dhe do të jenë bazë e fortë në të ardhmen për zhvillim rural lokal.

Pasi nga studimi i mbrojtjes konstatohet se zona ka karakteristikat e zonës së mbrojtur dhe pas shpalljes formale në përputhje me dispozitat e nenit 32 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, dhe në bazë të Aktit për Shpalljen, fillon themelimi i menaxhuesit.

Menaxhuesi i zonave të mbrojtura dhe zonave të rrejtit ekologjik duhet të plotësojë kushtet për sa i përket personelit, aftësive organizative për të kryer detyrat e mbrojtjes, avancimit, promovimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të zonës. Përbushja e kushteve përcaktohet nga ministria kompetente ose organi i qeverisjes lokale, dhe në bazë të Rregullores për kushtet specifike që duhet të plotësojë menaxhuesi i pasurive të mbrojtura natyrore ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", nr. 35/10, datë 25.06.2010).

Sipas kësaj rregulloreje, menaxhuesi i pasurive natyrore të mbrojtur në kategorinë e parkut nacional, rezervateve të rrepta dhe të veçanta të natyrës duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme për sa i përket kualifikimeve profesionale dhe personelit:

- të ketë të paktën tre punonjës me diplomë universitare ose të kryera studime të specializuara në fushën e mbrojtjes së natyrës (biologji, pylltari, bujqësi, ekologji ose gjeografi), me përvojë pune në profesion të paktën tre vjet.

Për një pasuri natyrore të mbrojtur në kategorinë e parkut të natyrës, menaxhuesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme për sa i përket kualifikimeve profesionale dhe personelit:

- të ketë të paktën një person të punësuar me diplomë universitare ose të kryera studime të specializuara në fushën e mbrojtjes së natyrës (të drejtimit biologji, pylltari, bujqësi, ekologji ose gjeografi), me përvojë pune në profesion të paktën tre vjet.

Gjithashtu, menaxhuesi duhet të kenë shërbim të organizuar të mbrojtjes për ruajtjen e pasurive të mbrojtura natyrore me një mbikëqyrës të punësuar për 3000 ha pasuri të mbrojtura natyrore, të cilët duhet të kenë të paktën diplomën e shkollës së mesme, një vit përvojë pune dhe të plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara nga akti i menaxhuesit.

Kur bëhet fjalë për pasuritë natyrore të mbrojtura në kategorinë e monumentit të natyrës, habitatit të mbrojtur, rajonit me veçori të jashtëzakonshme, llojeve të mbrojtura të bimëve, kafshëve dhe kërpudhave, objekteve të mbrojtura gjeologjike dhe paleontologjike, menaxhuesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme në aspektin profesional dhe kualifikimet e personelit:

- të ketë të paktën një punonjës me diplomë universitare ose të kryera studime të specializuara në fushën e mbrojtjes së natyrës (biologji, pylltari, bujqësi, ekologji ose gjeografi), me përvojë pune në profesion të paktën një vit, si dhe të paktën një mbikëqyrës të punësuar.

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, parqet nacionale menaxhohen nga Ndërmarrja Publike për Parqet Nacionale të Malit të Zi, ndërsa zonat e mbrojtura në zonën e të mirave detare (përveç parqeve kombëtare) menaxhohen nga Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e të Mirave Detare të Malit të Zi. Ligji parashikon gjithashtu që rezervati i rreptë natyror, rezervati i veçantë natyror, parku i natyrës, monumenti natyror dhe rajoni me veçori të jashtëzakonshme, të cilat ndodhen në territorin e parkut nacional, administrohen nga menaxhuesi i parkut nacional.

Për kategoritë e tjera të pasurive natyrore të mbrojtura (parku i natyrës, monumenti natyror dhe rajoni me veçori të jashtëzakonshme), menaxhuesi përcaktohet me Aktin për Shpalljen e Zonës së Mbrojtur, i cili propozohet dhe miratohet nga njësi e vetëqeverisjes lokale.



Dispozitat e nenit 56 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës parashikojnë detyrimet e menaxhuesit të zonës së mbrojtur sipas të cilave menaxhuesi është i detyruar të:

- miraton programin vjetor të menaxhimit dhe aktin mbi rendin e brendshëm;
- siguron shërbim e mbrojtjes;
- miraton planin financiar për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonës;
- miraton planin vjetor për zhvillimin dhe trajnimin e stafit;
- siguron zbatimin e masave për mbrojtjen e natyrës në përputhje me objektivat e mbrojtjes, zonat dhe regjimet e mbrojtjes;
- ruan, avancoon dhe promovon zonën e mbrojtur;
- shënon zonën e mbrojtur;
- siguron zhvillimit të papenguar të proceseve natyrore dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të zonës së mbrojtur;
- monitoron situatën në zonën e mbrojtur dhe i dorëzon të dhënat organit të administrativ;
- paraqet raport vjetor pranë Ministrisë, përkatësisht organit kompetent të qeverisjes lokale, për realizimin e planit të menaxhimit të zonave të mbrojtura, gjegjësisht programin vjetor të menaxhimit, masat e zbatuara, burimet financiare të shpenzuara për zbatimin e masave;
- kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj dhe aktin e themelimit.

Akti për Shpalljen e Zonës së Mbrojtur specifikon në mënyrë plotësuese dhe më të detajuar detyrimet e menaxhuesit.

SEGMENTET KRYESORE TË MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA

Zonat e mbrojtura karakterizohen nga kompleksiteti, kështu që fusha e punës së menaxhuesit është shumë e gjerë dhe mund të grupohet në kategoritë e mëposhtme:

- Ruajtja e vlerave natyrore
- Qëndrueshmëria e përdorimit të pasurive natyrore
- Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë dhe traditës kulturore
- Menaxhimi i vizitorëve, interpretimi dhe edukimi
- Bashkëpunimi me komunitetin lokal

Menaxhimi fillon me planifikimin e strategjive të nevojshme për të përmbushur vizionin dhe qëllimet e mbrojtjes dhe për të reduktuar kërcënimet, si dhe përcaktimin e aktiviteteve të menaxhimit që lidhen me selektimin e zgjidhjeve më të mira të vlerësuara për të arritur qëllimet e mbrojtjes.

Në Mal të Zi, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, dokumentet planifikuese që kanë të bëjnë me zonat e mbrojtura janë **planet pesëvjeçare të menaxhimit dhe programet vjetore të menaxhimit**, dhe sipas Ligjit për Parqet Nacionale, mbrojtja, avancimi dhe zhvillimi i parqeve nacionale bëhet edhe në bazë të planit hapësinor me dedikim të veçantë.

Sipas dispozitave të nenit 58 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, **plani i menaxhimit** të zonës së mbrojtur është dokument planimetric që planifikon masat dhe aktivitetet për mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë natyrore të mbrojtur, i cili paraqet bazën planifikuese për menaxhimin dhe shfrytëzimin e pasurisë natyrore për qëllime ekologjike, ekonomike dhe sociale.

Plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur është dokument i planifikimit strategjik (akt planifikimi) që përcakton **vizionin, qëllimin dhe gjendjen** e zonës së mbrojtur dhe përcakton qëllimet e menaxhimit



dhe/ose të ruajtjes, **aktivitetet** e nevojshme për arritjen e qëllimeve dhe **treguesit e zbatimit** të planit dhe efikasitetit të menaxhimit.

Plani i menaxhimit miratohet nga menaxhuesi dhe zbatohet në bazë të **programit vjetor të menaxhimit**, i cili hartohet dhe miratohet gjithashtu nga menaxhuesi, me pëlqimin e Ministrisë, përkatësisht organit kompetent të qeverisjes lokale. Programi vjetor i menaxhimit i dorëzohet Ministrisë, përkatësisht organit kompetent të qeverisjes lokale deri më 30 nëntor të vitit aktual për vitin pasardhës.

Në procesin e miratimit të Planit të Menaxhimit është obligativ edhe mendimi i Agjencisë për Mbrojtjes e Mjedisit.

Përmbajtja e Planit të Menaxhimit përcaktohet me nenin 59 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, i cili përcakton se plani përmban informacionin e mëposhtëm:

- 1) pasqyrën e burimeve natyrore dhe përdoruesve të zonës së mbrojtur;
- 2) vlerësimi i gjendjes së zonës së mbrojtur;
- 3) qëllimet afatgjata të mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- 4) analiza dhe vlerësimi i kushteve për arritjen e qëllimeve të mbrojtjes;
- 5) masat e mbrojtjes, ruajtjes, menaxhimit, avancimit dhe shfrytëzimit të zonave të mbrojtura;
- 6) mënyra e zbatimit të mbrojtjes, shfrytëzimit dhe menaxhimit të zonës së mbrojtur;
- 7) aktivitetet prioritare për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe monitorimin e vlerave dhe segmenteve natyrore dhe të tjera të mjedisit;
- 8) identifikimi hapësinor i dedikimeve të planifikimit dhe regjimit të përdorimit të tokës;
- 9) udhëzime për punën hulumtuese dhe shkencore;
- 10) udhëzime zhvillimore, udhëzime dhe prioritete për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonës së mbrojtur duke respektuar nevojat e popullatës lokale;
- 11) aktivitetet e planifikuara për përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, zhvillimin dhe rregullim hapësinor;
- 12) aktivitete për promovimin dhe valorizimin e zonës së mbrojtur;
- 13) mënyra e bashkëpunimit me popullsinë lokale, pronarët dhe shfrytëzuesit e pasurive të paluajtshme;
- 14) dinamikën dhe subjektet e zbatimit të planit të menaxhimit dhe mënyrën e vlerësimit të zbatimit;
- 15) fondet e nevojshme për zbatimin e masave mbrojtëse dhe burimet e financimit;
- 16) indikatorët për monitorimin e suksesit të zbatimit të planit;
- 17) elementë të tjerë me rëndësi për menaxhimin e zonës.

Qëllimi i monitorimit/përcjelljes së zbatimit të Planit të Menaxhimit është të sigurojë zbulimin në kohë të devijimeve në zbatimin e masave të planifikuara në lidhje me realizimin e qëllimeve specifike dhe operacionale të përcaktuara në Plan. Monitorimi gjithashtu siguron grumbullimin e përvojës së nevojshme për vlerësimet dhe korrigjimet e planit të menaxhimit.

Monitorimi i zbatimit të planit të menaxhimit në Mal të Zi kryhet përmes mekanizmit të **Raportit për zbatimin e programit vjetor të menaxhimit**, të cilin menaxhuesi ia dorëzon Ministrisë, përkatësisht organit kompetent të pushtetit lokal deri më 1 mars të vitit rrjedhës për vitin e kaluar.



Për çfarë shërben plani i menaxhimit?

Përmbledh informacionin më të rëndësishëm rreth ZM
Parashikon konfliktet e mundshme dhe përcakton zgjidhjet
Siguron vazhdimësinë e menaxhimit
Përcjell performancën dhe mundëson përshtatshmërinë e menaxhimit
Mundëson ndarje të qartë dhe efektive të resurseve
Lehtëson kërkimin e burimeve financiare
Ndihmon në komunikimin me përdoruesit e zonës
Mundëson shkëmbimin e njohurive dhe rritjen e mirëkuptimit
Ndihmon në drejtimin e përdorimit të hapësirës
Rrit transparencën

Praktika afatgjatë në menaxhimin e zonave të mbrojtura në botë, si dhe monitorimi i efektivitetit të tyre në ruajtjen e natyrës, ka treguar se parimet e përshtatshmërisë (adaptimit) dhe pjesëmarrjes janë të rëndësishme për sukses.

Menaxhimi adaptiv është proces rrethor që mundëson informacionin dhe përvojat e mbledhura nga e kaluara të përfshihen në planifikimin e ardhshëm me qëllim të avancimit të menaxhimit. Përshtatshmëria e menaxhimit sigurohet përmes programeve vjetore të menaxhimit, bazuar në monitorimin e zbatimit të planeve të menaxhimit dhe raporteve për zbatimin e programeve vjetore, d.m.th. duke bërë ndryshime në përputhje me ngjarjet dhe situatën në terren, si dhe në rastin e rrethanave të paparashikuara (fatkeqësi të mëdha, krizave ekonomike dhe shëndetësore dhe të ngjashme).

Kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen, ajo është një parakusht kryesor për menaxhim efektiv dhe të mirë të zonave të mbrojtura. Është e nevojshme të sigurohet pjesëmarrja e publikut që në fillim të procesit të shpalljes së zonës së mbrojtur për të minimizuar konfliktet, të cilat janë pjesë përbërëse e menaxhimit të çdo zone të mbrojtur. Konfliktet në shfrytëzimin e hapësirës paraqesin një pengesë për menaxhimin dhe arritjen e qëllimeve të mbrojtjes. Të gjitha analizat e efektivitetit të zonave të mbrojtura tregojnë se mungesa e bashkëpunimit me përdoruesit ndikon negativisht në arritjen e qëllimeve të mbrojtjes dhe qëndrueshmërinë e zonave të mbrojtura.

Kjo është arsyeja pse proceset e vendosjes dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura, duke përfshirë zhvillimin e planeve të menaxhimit, duhet të jenë participative.

◆ Menaxhimi i pasurive kulturore

Formimi i pronësisë shtetërore

Pronë shtetërore konsiderohet pasuria e luajtshme që është në tokë ose ujë, për të cilën besohet se ka vlerë kulturore, pavarësisht nëse është nxjerrë;

Menaxhimi i pasurive kulturore në pronë shtetërore



- Qeveria e Malit të Zi dhe autoriteti kompetent i komunës janë të detyruar të caktojnë subjektin që do ta menaxhojë atë, në përputhje me ligjin, për çdo pasuri kulturore në pronë të shtetit ose komunës.
- Nëse subjekti i caktuar për menaxhimin e pasurisë kulturore nuk e ruan ose nuk e përdor pasurinë kulturore në mënyrën e përcaktuar, Drejtoria është e obliguar t'i propozojë Qeverisë, përkatësisht organit kompetent të komunës, marrjes e pasurisë kulturore nga ai subjekti dhe t'ia jap për menaxhim një subjekti tjetër.
- Mjetet për shpenzimet e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së pasurisë kulturore që i transferohen një subjektit sigurohen nga shteti, përkatësisht komuna që disponon pasurinë kulturore.

Menaxhimi i pasurive kulturore në pronësi private

Prona kulturore në pronësi private menaxhohet nga pronari, nëse këtë të drejtë nuk ia ka kaluar me kontratë një personi tjetër.

Kujdestar i përkohshëm i pasurisë kulturore

Nëse pronari ose mbajtësi e ka braktisur përkohësisht pronën kulturore në pronësi private, dhe për këtë shkak ekziston rreziku i dëmtimit ose shkatërrimit të saj, Drejtoria do të caktojë kujdestarin të përkohshëm për atë pronë kulturore.

Kujdestari i përkohshëm është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rregullt të pasurisë kulturore, si dhe masat që shkojnë përtej mirëmbajtjes së rregullt, me pëlqimin paraprak të Drejtorisë. Kujdestari i përkohshëm ka të drejtën e kompensimit të punës dhe të kompensimit për shpenzimet që lidhen me punën.

Përdorimi (shfrytëzimi) i zonave të mbrojtura

Zonat e mbrojtura mund të përdoren në përputhje me studimin e mbrojtjes, përkatësisht planin hapësinor me dedikim të veçantë, planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur dhe në bazë të lejeve në përputhje me këtë ligj. Ndalohet përdorimi i zonave të mbrojtura në mënyrën që shkakton:

- dëmtimin e tokës dhe humbjen e pjellorisë së saj natyrore;
- dëmtimin e vlerave gjeologjike, hidrogjeologjike dhe gjeomorfologjike sipërfaqësore ose nëntokësore;
- dëmtimin e zonave të mbrojtura detare;
- varfërimin e fondit natyror të llojeve të egra të bimëve, kafshëve dhe kërpudhave;
- reduktimie e diversitetit biologjik dhe ekologjik;
- ndotjen ose rrezikimin e ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Veprimet, aktivitetet dhe veprimtaritë në zonat e mbrojtura, të cilat nuk i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me dispozitat e veçanta, vlerësimi i pranueshmërisë, të cilat nuk janë përcaktuar nga plani i menaxhimit, mund të kryhen vetëm me lejen e autoritetit administrativ.

◆ ***Përdorimi i pasurive kulturore***

Dedikimi i pasurisë kulturore

Pasuria kulturore mund përdoret për dedikime tradicionale ose të tjera të përshtatshme të përcaktuara nga Drejtoria.



Dedikimi i pasurisë kulturore përcaktohet për përdorimin e qëndrueshëm të saj, në një mënyrë që siguron dhe respekton integritetin e saj dhe kuptimin e vlerës kulturore.

Përdorimi i pasurisë kulturore për qëllime të veçanta

Pasuria kulturore ose pjesa e saj mund të përdoret për reklamim, si element i kompanisë, për prodhimin e suvenireve, materialeve filmike ose fotografike ose për qëllime të tjera komerciale, në mënyrë që nuk cenohet integriteti i saj, në bazë të lejes së Drejtorisë.

Koncesioni për pasurinë kulturore

Pasuritë kulturore të paluajtshme shtetërore mund të vihen në dispozicion për përdorim nëpërmjet koncesionit, në përputhje me ligjin që rregullon koncesionet dhe këtë Ligj, për kryerjen e:

- 1) veprimtarive turistike, hoteliere, tregtare, artizanale ose të shërbimeve tjera;
- 2) Veprimtarive origjinale ose të lidhura industriale respektivisht prodhuese;
- 3) Veprimtarive në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, informacionit, shëndetësisë, sportit dhe rekreacionit.

Subjekti i koncesionit nuk mund të jetë një pasuri kulturore, siç është:

- 1) lokaliteti arkeologjik i paeksploruar;
- 2) objekt përkujtimor, memorial dhe vendi kulturor ose i rëndësishëm;
- 3) vendi dhe objekti i lidhur me zakonet, besimin ose traditën;
- 4) rezervat arkeologjik.

Koncesioni i një pasurie kulturore mund t'i jepet personit juridik ose fizik vendas ose të huaj, i cili përveç kushteve të përcaktuara me ligj, plotëson edhe kushtet e mëposhtme:

- 1) se është i regjistruar për kryerjen e veprimtarive nga neni 59 paragrafi 1 i Ligjit, d.m.th. në përputhje me dispozitat e një shtetit anëtar të Bashkimit Evropian.;
- 2) të ketë programin e rivitalizimi dhe planin për menaxhimin e pasurisë kulturore.

Pasuria kulturore e paluajtshme shtetërore ose një pjesë e saj mund të jepet me qira deri në 90 ditë, pa shpallje publike.

Partneriteti publik-privat

Fondet për shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurisë së paluajtshme kulturore mund të sigurohen edhe nga partneriteti publiko-privat në përputhje me ligjin e veçantë.

◆ Të drejtat dhe detyrimet e personave fizikë dhe juridikë në zonat e mbrojtura

Personi juridik ose fizik i cili është pronar i pronës së paluajtshme brenda kufijve të zonës së mbrojtur dhe/ose zonës së rrejtit ekologjik dhe që synon të shesë pronën e paluajtshme, është i detyruar që pronën e paluajtshme së pari t'ia ofrojë Qeverisë ose njësisë së vetëqeverisjes lokale, nëpërmjet autoritetit administrativ përgjegjës për pronën. Oferta duhet të përmbajë çmimin dhe kushtet e shitjes. Nëse Qeveria ose njësia e vetëqeverisjes lokale nuk e pranon ofertën brenda 60 ditëve nga dita e dorëzimit të ofertës, pronari nuk mund t'ia shesë pronën e paluajtshme një personi tjetër me kushte më të favorshme sesa kushtet në të cilat ia ka ofruar Qeverisë ose njësisë së vetëqeverisjes lokale, në të kundërt kontrata është e pavlefshme.



Të drejtat pronësore mbi pasurinë e paluajtshme që është pjesë e pasurisë natyrore të mbrojtur mund të kufizohen - shpronësohen kur këtë e kërkon interesi publik. Procedura e shpronësimit të pasurisë së paluajtshme kryhet në përputhje me ligjin që rregullon fushën e shpronësimit.

Pronari i pasurisë së paluajtshme është i detyruar të ndërmarrë masa dhe veprime (rrethim, ruajtje të pasurisë dhe shpërndarje të llojeve të mbrojtura të kafshëve) për të parandaluar shfaqjen e dëmeve që mund të shkaktohen nga llojet e egra të kafshëve të mbrojtura. Pronari i pasurisë së paluajtshme brenda kufijve të një pasurie natyrore të mbrojtur ka të drejtën e kompensimit të dëmeve, me kusht që të ketë marrë masa dhe veprime për të parandaluar dëmtimin nga llojet e mbrojtura të kafshëve të egra. Në këtë drejtim, pronari i pasurisë së paluajtshme është i detyruar t'i raportojë menaxhuesit ndodhjen e dëmit jo më vonë se tetë ditë nga data e shfaqjes së dëmit. Vlerësimi i dëmit përcaktohet nga komisioni i formuar nga menaxhuesi. Masa e kompensimit të dëmit në bazë të vlerësimit të komisionit për vlerësimin e dëmit caktohet nga menaxhuesi me anë të aktvendim.

Pronari i pasurive të paluajtshme, të cilit i kufizohet e drejta për të përdorur dhe disponuar pasurinë e paluajtshme, ka të drejtën e kompensimit të dëmit në raport me uljen e të ardhurave të krijuara në momentin e shpalljes së zonës së mbrojtur. Pronari i pasurisë së paluajtshme i paraqet menaxhuesit kërkesën për shpërbllimin e dëmit, **shoqëruar me dëshmi për uljen e të ardhurave** që mund të kishte arritur në momentin e shpalljes së zonës së mbrojtur ose që mund të kishte arritur, e cila rezulton nga kufizimet që rrjedhin nga shpallja e zonës të mbrojtur. Masa e kompensimit përcaktohet me kontratë ndërmjet menaxhuesit dhe pronarit të pasurisë së paluajtshme. Nëse brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim, pronari i pasurisë së paluajtshme dhe menaxhuesi nuk bien dakord për masën e kompensimit, masën e kompensimit e cakton gjykata kompetente.

Pronarët e pasurive të paluajtshme janë të detyruar të lejojnë menaxhuesit, organit administrativ dhe personit që ka leje të bëjë hulumtime për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj. Nëse pronari i paluajtshmërisë i shkakton dëm pronës natyrore të mbrojtur gjatë kryerjes së veprimeve dhe aktiviteteve, ai është i detyruar të zbatojë masa rehabilituese, në përputhje me ligjin që rregullon përgjegjësinë për dëmtimin e mjedisit. Nëse menaxhuesi i pasurisë natyrore të mbrojtur, organi administrativ ose personi që ka licencë për të bërë hulumtime dhe kryerjen e punëve të përcaktuara me ligj, i shkakton dëm pronarit të pasurisë së paluajtshme gjatë kryerjes së veprimeve dhe aktiviteteve, pronari duhet të dëmshpërblehet për dëmin. Pronari i pasurisë së paluajtshme është i detyruar t'i raportojë menaxhuesit ndodhjen e dëmit jo më vonë se tetë ditë nga data e shfaqjes së dëmit. Masa e dëmshpërblimit përcaktohet nga komisioni për vlerësimin e dëmit. Shpërblimi i dëmit të pronarit të paluajtshmërisë paguhet nga personi që e ka shkaktuar dëmin gjatë kryerjes së veprimeve dhe aktiviteteve.

◆ **Të drejtat dhe detyrimet e pronarëve dhe mbajtësve të pasurisë kulturore**

E drejta për ndihmë profesionale

Pronari dhe mbajtësi i pasurisë kulturore kanë të drejtën e ndihmës profesionale falas për këto çështje:

- Inspektimi, përcaktimi i gjendjes dhe shpjegimi i veçorive dhe rëndësisë së pasurisë kulturore;
- Këshilla dhe udhëzime në lidhje me ruajtjen, mirëmbajtjen, respektimin dhe përdorimin e pasurisë kulturore;
- T'i tregohet për nevojën e marrjes së masave mbrojtëse;
- Mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore.



Doracak: Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore, vendosjen e menaxhimit me analiza të kapaciteteve dhe mangësive në territorin e Komunës së Ulqinit

- E drejta për ndihmë profesionale ushtrohet nga Drejtoria dhe institucionet publike për mbrojtjen e pasurive kulturore.

E drejta për mbështetje financiare


Pronari i pasurisë kulturore ka të drejtën e mbështetjes financiare nga shteti për mirëmbajtjen e pasurisë kulturore dhe për zbatimin e masave konservuese që tejkalojnë kostot e mirëmbajtjes së rregullt, në përputhje me ligjin.

E drejta e kompensimit të dëmit

Pronari i pasurisë kulturore ka të drejtën e kompensimit për dëmet, nëse:

- Masa e mbrojtjes e përcaktuar nga Drejtoria kufizoi shfrytëzimin ekonomik të pasurisë kulturore, për qëllime tradicionale apo të tjera të miraturo;
- Për shkak të hulumtimit apo zbatimit të masave mbrojtëse, të cilat kryhen nga personi i caktuar nga Drejtoria, dëmtohet pasuria kulturore.

Kompensimi i dëmit për këto arsye realizohet me Drejtorinë.



Skema 6. Të drejtat e pronarëve dhe mbajtësve të pasurisë kulturore

Raportimi i ndryshimeve

Pronari, respektivisht mbajtësi i pasurisë kulturore, është i detyruar që çdo ndryshim ligjor dhe fizik të pasurisë kulturore t'ia raportojë Drejtorisë menjëherë dhe jo më vonë se brenda tetë ditëve.

Ruajtja, mirëmbajtja dhe zbatimi i masave mbrojtëse

Pronari i pasurisë kulturore është i detyruar të ruajë pasurinë kulturore, ta përdorë atë në mënyrën e duhur, ta mirëmbajë rregullisht dhe të zbatojë me kohë masat e tjera mbrojtëse të përcaktuara ose të definuara.

Nëse pronari, respektivisht mbajtësi i pasurisë kulturore nuk e trajton pronën kulturore siç parashikohet me Ligj, Drejtoria do ta urdhërojë atë që të ndërmarrë masat e nevojshme mbrojtëse brenda një afati të



Doracak: Procedurat për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore, vendosjen e menaxhimit me analiza të kapaciteteve dhe mangësive në territorin e Komunës së Ulqinit

caktuar dhe do ta paralajmërojë atë se në rast të mosrespektimit të aktvendimit, masat e urdhëruara të mbrojtjes do të kryhen me shpenzimet e tij.

Lejimi i hulumtimeve dhe zbatimi i masave mbrojtëse

Pronari, respektivisht mbajtësi i pasurisë kulturore, është i detyruar që, pas njoftimit paraprak, të lejojë Drejtorinë dhe personat tjerë të autorizuar nga Drejtoria të inspektojë, regjistrojë, dokumentojë, hulumtojë dhe inçizojë pasurinë kulturore, të marrë mostra materiale dhe të zbatojë masat e caktura mbrojtëse.

Vendosja e pasurisë kulturore në dispozicion të publikut

Subjekti që menaxhon pasurinë kulturore shtetërore dhe bashkësia fetare janë të detyruar, në përputhje me natyrën dhe dedikimin e pasurisë kulturore dhe organizimin e punës së tyre, të mundësojnë qasjen individuale dhe kolektive në pasurinë kulturore që posedojnë.

Këta persona janë të detyruar, me kërkesë të institucionit publik të mbrojtjes së pasurisë kulturore, të mundësojnë që përkohësisht pasuria kulturore që zotërojnë të prezantohet në publik.

Pronarët, respektivisht mbajtësit e pasurisë kulturore mund të përcaktojnë kompensim për akses në pasurinë kulturore, përpos në raste të përcaktuara me Ligj.

OBLIGIMET

RAPORTIMI I
NDRYSHIMEVE

RUAJTJA,
MIRËMBAJTJA DHE
ZBATIMI I MASAVE
MBROJTJES

LEJIMI I HULUMTIMEVE
DHE ZBATIMI I MASAVE
MBROJTJES

MUNDËSIMI I AKSESIT
NË PASURINË
KULTURORE PËR
PUBLIKUN

Skema 7. Të drejtat e pronarëve dhe mbajtësve të pasurisë kulturore



◆ Analiza e kapaciteteve dhe mangësisë në Komunën e Ulqinit për vendosjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore

Për të analizuar dhe vlerësuar në mënyrë adekuate kapacitetin e Komunës së Ulqinit për vendosjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe pasurive kulturore, është realizuar pyetëtori me 31 pyetje. Në të njëjtin janë përgjigjur 14 persona, dhe atë: Komuna e Ulqinit – 6, Muzeu i Ulqinit 1, OJQ Valdanosi, OJQ "Labeatët"-Ulqin, Shoqata për zhvillim të qëndrueshëm, bashkëpunim rajonal dhe ullirishtari VALDANOSI -2, Organizata Turistike e Ulqinit, Qendra për Kulturë e Ulqinit, intelektual i pavarur.

Bazuar në rezultatet e Pyetëtorit (Shtojca I), u arrit në përfundimin se:

- Në të gjitha institucionet dhe organizatat ka një numër minimal të pozitive teknike që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës dhe pasurive kulturore, dhe se më së shpeshti përshkrimi i punës së këtyre pozitive përfshin edhe punët tjera në organizatë dhe jo vetëm temat e përmendura. Gjithashtu, u vërejt se stafi i kushton pak ose të pamjaftueshme kohë këtyre temave.
- Është konstatuar se pozitat kryesore drejtuese dhe teknike në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore plotësohen pjesërisht nga njerëz që kanë kualifikimet dhe aftësitë e duhura.
- Kur bëhet fjalë për mundësinë për të marrë pjesë në trajnime lidhur me mbrojtjen e natyrës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, u vlerësua se ekziston herë pas here dhe në një masë të kufizuar, ndërsa 90% e të anketuarve vlerësuan programet e disponueshme të trajnimit në Mal të Zi për temën e mbrojtjes së natyrës të vogël dhe të pamjaftueshëm.
- Shumica e të anketuarve (60%) deklaruan se janë të njohur me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligjin për Pasuritë Kulturore, ndërsa 30% e të anketuarve nuk janë të njohur me ligjet e lartpërmendura.
- 50% e të anketuarve nuk janë të njohur me detyrimet e pushtetit lokal në lidhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, ndërsa 30% janë të njohur deri në një masë dhe 20% janë plotësisht të njohur, ndërsa në lidhje me Ligjin për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore 50% janë të njohur deri në një masë, 40% jo të njohur dhe 10% plotësisht të njohur.
- Kur bëhet fjalë për pyetjet individuale nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji për Pasuritë Kulturore (si procedurat e mbrojtjes, kufijtë, zonat mbrojtëse, vendosja dhe menaxhimi i detyrimeve, etj.), të anketuarit kryesisht janë përgjigjur se nuk janë të njohur ose ishin të njohur deri diku. Veçanërisht vihet re mungesa e njohjes së të drejtave/detyrimeve të pronarëve të pasurive kulturore dhe procedurave bazë në trajtimin e tyre (pak më shumë se 50% e të anketuarve i njohin deri në një masë procedurat, ndërsa pjesa tjetër nuk ka fare njohuri).

Prandaj, në bazë të pyetëtorit të realizuar, mund të konstatohet qartë se kapacitetet në territorin e Komunës së Ulqinit për çështjet e mbrojtjes së natyrës dhe pasurive kulturore nuk janë të mjaftueshme dhe se ekziston nevoja për avancimin e kapaciteteve ekzistuese si përmes vazhdimësisë me trajnime për këto çështje dhe përmes planifikimit dhe hapjes së vendeve të reja të punës në mënyrë specifike për çështjet e mbrojtjes së natyrës dhe pasurive kulturore, si dhe rritjes së numrit të projekteve për edukimin dhe përfshirjen e komunitetit lokal (ullishtarët dhe OJQ lokale) lidhur me këto çështje.



◆ **Rekomandime**

Bazuar në pasqyrën e gjendjes aktuale, obligimeve dhe nevojave të Komunës së Ulqinit dhe palëve të interesuara në territorin e Komunës së Ulqinit lidhur me procedurat për vendosjen e mbrojtjes së pasurive natyrore dhe kulturore dhe menaxhimin adekuat të tyre, në vijim ofrojmë disa rekomandime për të përmirësuar situatën:

- Të planifikohet në Komunën e Ulqinit Sekretariati i veçantë për mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe në kuadër të tij të planifikohen minimumi katër vende pune vetëm për këto çështje.;
- Për zonat e mbrojtura ekzistuese, nëse nuk është bërë deri tani, të caktohet menaxhuesit dhe formohen organet drejtuese me shërbime për mbrojtje që do të punësojnë fuqi punëtore profesionale dhe do të sigurojnë menaxhim efikas të zonave të mbrojtura. Në këtë kuptim, duhet marrë parasysh modelet më optimale të bashkëpunimit si partneriteti privat-publik, besimi i detyrave të menaxhimit shoqatave lokale (p.sh. promovimi i turizmit) ose organizatave lokale të shoqërisë civile;
- Të formohet komisioni në nivel lokal që do të monitorojë gjendjen e pasurive kulturore në territorin e komunës së Ulqinit dhe periodikisht të përgatisë raportin. Detyrë e komisionit është të komunikojë me institucionet shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- Pasuritë e mbrojtura kulturore, të cilat janë në pronësi të Komunës së Ulqinit ose Qeverisë së Malit të Zi, të mirëmbahen rregullisht në bashkëpunim me institucionet lokale kulturore dhe sekretariatit përgjegjës për veprimtari komunale;
- Miratimi i të gjitha akteve të nevojshme për menaxhim dhe ofrimi i mbështetjes për financimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura përmes buxhetit të Komunës së Ulqinit;
- Të krijohet plani i trajnimit për zyrtarët e të gjitha sekretariateve përkatëse në Komunën e Ulqinit dhe të bashkëpunohet me institucionet shtetërore për realizimin e trajnimeve si dhe me organizatat e sektorit civil për planifikimin e projekteve të përbashkëta në këtë drejtim;
- Formimi i organit të përhershëm siç është Trupi Këshillues ose grupi i punës që do të përfshijë organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues të shoqatave/palëve të interesuara me qëllim të avancimit të çështjes së mbrojtjes së natyrës dhe mbrojtjes së pasurive kulturore në territorin e Komunës së Ulqinit;
- Të paraqiten iniciativa për mbrojtjen parandaluese ose të plotë të të gjitha zonave me vlerë të identifikuar deri më tani nga aspekti i mbrojtjes së natyrës (Liqeni i Shasit, Delta e Bunës, Valdanosi, etj.);
- Në nivel lokal të parashikohet përgatitja e një dokumenti (Studimi, Elaborimi) i cili do të analizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse trashëgiminë kulturore të njohur në territorin e komunës së Ulqinit dhe do të japë rekomandime për valorizimin e saj në raport me nevojat dhe mundësitë e komunitetit lokal;
- Në kontekstin e pasurisë kulturore dhe trashëgimisë kulturore, meqë anketa theksoi veçanërisht mosnjohjen e të drejtave/detyrimeve të pronarëve të pasurisë kulturore dhe procedurave bazë në trajtimin e tyre, është e nevojshme të intensifikohet komunikimi ndërmjet popullatës dhe shërbimeve lokale përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, nëpërmjet këshillimit dhe edukimit.
- Të punohet me Organizatën Lokale Turistike për të promovuar vlerën dhe përmbajtjen interesante të zonave të mbrojtura, si dhe hartimin e aktiviteteve shtesë rekreative që kontribuojnë në valorizimin e këtyre zonave në përputhje me mbrojtjen e natyrës.;
- Të bashkëpunohet me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet shtetërore në fushën e planifikimit të projekteve që mund të përmirësojnë zonat e mbrojtura në territorin e Komunës së Ulqinit;

◆ **Literatura:**


- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës ("Fletorja Zyrtare e Mali të Zi", nr. 054/16 datë 15.08.2016, 018/19 datë 22.03.2019)
- Rregullorja për kushtet specifike që duhet të plotësojë menaxhuesi i pasurisë natyrore të mbrojtur ("Fl. Zyrtare e Mali të Zi", nr. 35/10 datë 25.06.2010)
- Ligji për Parqet Nacionale, "Fl. Zyrtare e Mali të Zi", nr. 028/14, 039/16
- Ligji për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore ("Fl. Zyrtare e Mali të Zi", nr. 049/10 datë 13.08.2010, 040/11 datë 08.08.2011, 044/17 datë 06.07.2017, 018/19 datë 22.03.2019)
- Rregullorja për kriteret dhe procedurën më të afërt për përcaktimin e vlerës kulturore të pasurisë („Fl. Zyrtare e Mali të Zi nr. 41/11 datë 10.08.2011“)
- Rregullorja për llojet, kushtet dhe metodat e kryerjes së hulumtimeve, llojet dhe përmbajtjen e dokumentacionit për hulumtime dhe përmbajtjen e elaboratit për hulumtim dhe mbrojtjen e pasurive kulturore. („Fl. Zyrtare e Mali të Zi“, nr. 41/11 datë 10.08.2011);
- Appleton, M.R. (2016): A Global Register of Competences for Protected Area Practitioners. Gland, Switzerland: IUCN
- Katnić A & Stritih J, 2014, Analiza e opsioneve për menaxhimin e zonave të mbrojtura në Mal të Zi
- Gjendja e trashëgimisë kulturore të Malit të Zi, 2006. Ministria e Kulturës dhe Medie. DPC: Podgoricë;
- Studimi i mbrojtjes së pasurive kulturore për qëllime të hartimit të Planit Hapësinor Urbanistik të Komunës së Ulqinit (Drejtoria për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore, 2016);
- Drafti i Elaboratit për rivlerësimin e pasurive kulturore nga territori i komunës së Ulqinit. (Drejtoria për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore, 2014).






◆ Shtojca I - Rezultatet e Pyetësorit

1. Sa pozicione drejtuese dhe teknike në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe pasurive kulturore ka në institucionin/organizatën tuaj?



2. A ka pozita që ende nuk janë hapur apo plotësuar? Sa prej tyre?




3. Sipas përshkrimit të punës, a janë ato pozita të lidhura vetëm me temën e mbrojtjes së natyrës apo me temën e mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi dhe/ose ato pozita janë përgjegjëse edhe për disa punë të tjera në organizatë?






4. Sipas përshkrimit të punës, a janë këto pozita të lidhura vetëm me temën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore këto pozita janë përgjegjëse edhe për disa punë të tjera në organizatë?



- Po, ato kanë të bëjnë me temën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore
- Po, por përveç temave të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, përshkrimi i punës përfshin edhe aktivitete të tjera më të gjera
- Jo, nuk thuhet qartë se përshkrimi i punës i referohet mbrojtjes së trashëgimisë kulturore

5. A janë të mounura me njezër që kanë kualifikimet dhe arsimin e duhur për pozitat kryesore drejtuese dhe teknike që lidhen me mbrojtjen e natyrës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?




- Jo
- Pjesërisht
- Po

6. Sa nga koha e tyre e punës shpenzon stafi përkatës në institucionin tuaj për detyra që lidhen me mbrojtjen e natyrës dhe trashëgimisë kulturore?



- Pak
- Aspak
- Pamjaftueshëm
- Mjaftueshëm


7. A ka mundësi stafi juaj të marrë pjesë në trajnime lidhur me mbrojtjen e natyrës dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore? Nëse po, çfarë lloje trajnime përdorni?



- Jo
- Herë pas here
- Në një masë të kufizuar
- Po, rregullisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse




8. Deri në çfarë mase janë të disponueshme programet e trajnimit në Mal të Zi mbi temën e mbrojtjes së natyrës?




- Pak
- Aspak
- Pamjaftueshëm
- Mjaftueshëm

9. A i konsideroni të mjaftueshme? Nëse jo, çfarë programesh specifike trajnimi do të ishin të nevojshme për të ngritur kapacitetet e punonjësve tuaj në çështjen e mbrojtjes së natyrës dhe trashëgimisë kulturore - përmendni temat më të rëndësishme sipas jush?




- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po

10. A jeni njohur me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës?



- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po

11. A jeni njohur me Ligjin për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore?



- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po



13. A jeni njohur me detyrimet e pushtetit lokal në lidhje me Ligjin për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore?




- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po

14. A jeni njohur me llojet e pasurive natyrore të mbrojtura dhe, nëse po, me dallimet ndërmjet kategorive të njëjta dhe të ndryshme të mbrojtjes?




- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po, por nuk jam i njohur me dallimet midis kategorive të njëjta dhe të ndryshme të mbrojtjes
- Po, por jam diçka i njohur me ndryshimet midis kategorive të njëjta dhe të ndryshme të mbrojtjes
- Po, jam plotësisht i njohur

15. A jeni njohur me llojet e pasurive kulturore të mbrojtura dhe, nëse po, me dallimet ndërmjet kategorive të njëjta dhe të ndryshme të mbrojtjes?



- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po, por nuk jam i njohur me dallimet midis kategorive të njëjta dhe të ndryshme të mbrojtjes
- Po, por jam diçka i njohur me ndryshimet midis kategorive të njëjta dhe të ndryshme të mbrojtjes
- Po, jam plotësisht i njohur


16. A jeni njohur me procesin e inicimit dhe shpalljes së zonave të mbrojtura?



- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po




17. A jeni njohur me zonat dhe regjimet e mbrojtjes?




- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po

18. A jeni njohur me procedurën për fillimin e iniciativës për zbatimin e procedurës për vendosjen e mbrojtjes së pasurive kulturore?




- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po

19. A jeni njohur me kushtet për shpalljen e mbrojtjes së peizazhit kulturor si lloj pasurie kulturore?



- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po



20. A jeni njohur me kufijtë e pasurive kulturore, mjediset e tyre të mbrojtura dhe regjimet e mbrojtjes?





- Jo
- Në një masë të caktuar
- Po




21. A jeni njohur me parimet e përdorimit të zonave të mbrojtura?





22. A jeni njohur me detyrimet e drejtuesve të zonave të mbrojtura?



23. A jeni njohur me detyrimet e pronarit/mbajtësit të pasurisë kulturore?




24. A e dini se çfarë është plani i menaxhimit të zonës së mbrojtur dhe për çfarë shërben?







25. A e dini se çfarë është plani i menaxhimit të pasurisë kulturore dhe për çfarë shërben?




26. A e dini se çfarë është studimi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe si zbatohet në planet hapësinore?



27. A jeni njohur me detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të mbrojtjes në zonat e mbrojtura?




28. A jeni njohur me detyrimet e sekretariateve lokale lidhur me aktivitetet që lidhen me ndërhyrjet në asetet e mbrojtura kulturore?






29. A jeni njohur me detyrimet dhe përgjegjësitë e shërbimit të mbrojtjes në lidhje me të mirat kulturore të mbrojtura?



30. Jeni njohur me rrejetin ekologjik Natura 2000?



31. A jeni njohur me konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Mali i Zi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore? (psum)

